

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIONIN

Një sistem Cilësie për Statistikat

Aktiviteti 1.2.1.1: Organizimi i punës rreth cilësisë në statistika: Takimi me përdoruesit

Komponenti 1

Misioni i realizuar nga Lars Thygesen, Hilikka Vihavainen & Annegrete Wulff

20-24 Tetor 2014

IPA 2012

Emri, emaili, adresa e autorit

*Lars Thygesen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +4539173941
Email: lth@dst.dk*

*Hilkka Vihavainen
Statistics Finland
Verkstadsgatan 13
FI-00022 Helsinki
Finland
Tel: +358 50 5002296
Email: hilkkal.vihavainen@gmail.com*

*Annegrete Wulff
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +4539173155
Email: awu@dst.dk*

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	3
1. Komente të përgjithshme	4
2. Vlerësimi dhe rezultatet	4
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	6
3.1 Databanka statistikore	6
3.2 Komunikimi me qeverinë dhe përdoruesit kyç	6
3.3 Rekomandimet për punën e Grupit për Cilësi	6
3.4 Misioni i ardhshëm.....	7
Puna në të ardhmen	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Aneksi 1. Termat e Referencës	8
Aneksi 2. Personat e takuar	11

Lista e shkurtesave

CoP	Kodi i Praktikës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
QAF	Korniza e Sigurimit të Cilësisë (Eurostat)
TeR	Termat e Referencës
SAQ	Pyetësori i vetëvlerësimit
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Nderkombetar
SIMS	Struktura e vetme e integruar për metadatat (standard i EUROSTAT-it për metadatat)

1. Komente të përgjithshme

Ky raport mbi misionin është realizuar në kuadër të Projektit të Binjakëzimit „Përkrahje për Statistikat”. Është misioni i gjashtë kushtuar komponentit 1 të projektit. Detyrë kryesore ishte përkrahja e ASK-së në realizimin e një takimi me përdoruesit e statistikave zyrtare. Përveç kësaj, një qëllim tjetër ishte monitorimi i arritjeve të realizuara deri tani dhe ofrimi i rekomandimeve se si të zhvillohet më tej puna rreth cilësisë në ASK.

Konsulentët dëshirojnë të falënderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e konsulentëve dhe e kanë bërë qëndrimin në Kosovë të këndshëm dhe të paharrueshëm.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së, Statistikave të Danimarkës/Finlandës.

2. Vlerësimi dhe rezultatet

Takimi me përdoruesit

Aktiviteti kryesor, i realizuar gjatë misionit, ishte takimi me përdoruesit e statistikave zyrtare. Morën pjesë përfaqësues të 13 institucioneve shumë të rëndësishme, përdorues të statistikave, si Ministria e Financave, Banka Qendrore, ministritë e tjera, hulumtues dhe organizata ndërkombëtare. Programi ishte si më poshtë

- Fjalimi përshëndetës, Z. Isa Krasniqi, Kryeshef Ekzekutiv në ASK
- Prezantimi i cilësisë statistikore, Z. Lars Thygesen
- Prezantimi i politikës së cilësisë, Z. Ramiz Ulaj
- Prezantimi i databazës statistikore, Znj. Annegrete Wulff
- Prezantimi i dialogut me përdoruesit, Znj. Hilka Vihavainen
- Diskutim rreth nevojave të përdoruesve dhe plotësimi i pyetësorit mbi kënaqshmërinë e përdoruesve

Takimi me përdoruesit ishte një aktivitet i suksesshëm. Në veçanti interesim të madh zgjoi prezantimi i databazës statistikore. Pas këtij prezantimi, të pranishmit duartrokitën spontanisht dhe shprehën entuziazmin e tyre për këtë mjet të ri, të cilin e kërkonin sa më shpejt që është e mundur. Fatkeqësisht, ASK-ja nuk mundi të japë një kohë të saktë, se kur do të jetë në dispozicion kjo databazë.

Përfaqësues të 11 institucioneve plotësuan pyetësorin mbi kënaqshmërinë e përdoruesve. Një përmbledhje e tyre paraqitet në aneksin 2. Doli që përdoruesit kërkojnë rregullisht statistika nga ASK-ja dhe shërbimet e ASK-së i konsiderojnë të mira. Kishte disa komente, që duhet të merren në konsideratë nga ASK-ja në të ardhmen.

Takime me Grupin për Cilësi

Konsulentët kanë mbajtur tri takime me Grupin për Cilësi. Në takimin e parë, u fol për përgatitjet rreth takimit me përdoruesit. Në takimin e dytë u diskutuan këto çështje:

- Vlerësimi i takimit me përdoruesit: të gjithë ranë dakord, që takimi ishte i suksesshëm dhe një fillim i mirë për takime të tjera në të ardhmen.
- Deklarata e cilësisë: kryesuesi i Grupit për Cilësi tregoi që deklarata është finalizuar dhe miratuar në ASK por, para se të bëhet publike, menaxhmenti i ASK-së po pret një përgjigje konsultative nga zyra ligjore e qeverisë.

- Anketa për mangësitë/nevojat: kjo anketë është realizuar për here të pare me stafin. Megjithatë, duhet elaborim dhe diskutim i mëtejme brenda organizatës sepse rezultatet nuk janë plotësisht të krahasueshme. Ka pasur vlerësime të ndryshme të performances së tyre nga ana e stafit, disa si të mbikualifikuar, disa të tjerë të nënkualifikuar. Përveç kësaj, menaxhmenti i ASK-së duhet të vendosë se cilat kompetenca janë të nevojshme për organizatën dhe në çfarë niveli.
- Grupi për Cilësi: mandati i këtij grupi është miratuar nga Kryeshefi por pritet një përgjigje zyrtare nga zyra ligjore. Grupi ka pasur disa takime deri tani, ku ka diskutuar mandatin, deklaratën e cilësisë, listën kontrolluese dhe anketën mbi mangësitë/nevojat e stafit. Konsulentët theksuan edhe një here rëndësinë e një plani të punës për Grupin dhe takimeve të rregullta të tij.
- Lista kontrolluese: tashmë është aplikuar në disa anketa dhe ka qenë e dobishme. Është ndryshuar një nga pikët në këtë listë. Gjithashtu, konsulentët theksuan që mund të shtohen rreshta të rinj në listë, sipas nevojave të ASK-së.
- Takime të rregullta me përdoruesit: kjo çështje përmendet edhe në planin e punës të ASK-së për vitin 2015, por jo dhe më shumë informacion se si do të realizohet kjo.
- Vetë-vlerësimi i Kodit të Praktikës: konsulentët prezantuan shkurt pyetësin për vetë-vlerësimin e Kodit të Praktikës, të cilën e kanë plotësuar të gjitha zyret statistikore të vendeve të BE-së, para procesit të vlerësimit. Ata propozuan që Grupi për Cilësi mund të provojë të plotësojë disa nga pjesët e këtij pyetësi vetë-vlerësimi. Kjo do të mund të kontribuonte në ide të reja për zhvillimin e mëtejme të cilësisë në ASK. parimi numër katër (deklarata e cilësisë) është një fillim i mirë. Në diskutim u theksua që koordinimi në nivel vendi nuk është në nivelin e duhur. Për këtë arsye, u propozua që ASK-ja mund të plotësojë edhe pyetësin mbi koordinimin. Kjo do të ndihmonte në identifikimin e problemeve të mundshme. Përveç kësaj, u tha që ka praktika të mira të vendeve të BE-së, në rast se ASK-ja dëshiron të dijë më shumë rreth kësaj teme.
- Deklaratat e cilësisë dhe metadatat: kjo fushë nuk është më përgjegjësi e projektit të binjakëzimit por pasi metadatat e mira janë esenciale për deklaratat e cilësisë, konsulentët pyetën rreth gjendjes lidhur me këtë temë. Megjithatë, nuk ka pasur progress gjatë muajve të fundit. Takimi i parë mbi metadatat do të mbahet në fillim të dhjetorit.

Konsulentët bënë disa prezantime : një nga Statistikat e Danimarkës lidhur me rëndësinë e raporteve me përdoruesit për aktivitetet e organizatës. Prezantimi tjetër ishte mbi parimet e shprehimeve nga Statistikat e Finlandës.

Takimi i tretë me Grupin për Cilësi u përqëndrua në rezultatet e këtij misioni dhe rekomandimet për të ardhmen, të cilat paraqiten në seksionin në vazhdim.

Konsulentët gjithashtu u takuan me Kryeshefin Ekzekutiv, Z. Isa Krasniqi. Qëllimi i këtij takimi ishte të theksohet rëndësia e reagimit të shpejtë të ASK-së ndaj nevojave të përdoruesve, të paraqitura në takim. Përveç kësaj, u diskutua edhe nevoja për misionin mbi koordinimin dhe azhurnimin e Ligjit të Statistikave.

3. Konkluzione dhe rekomandime

3.1 Databaza statistikore

Krijimi dhe hapja e Databazës Statistike duhet të jetë prioritet kryesor, sidomos për muajt në vijim. Databanka do të duhej të hapej në webin e ASK-së kah fundi i vitit me disa nga të dhënat. Për fillim do të duhej të ketë së paku dy kube të rëndësishme, të cilat do të azhurnohen vazhdimisht.

Është shumë e rëndësishme të shfrytëzohet momenti i entuziazmit të përdoruesve. Ata presin që ASK-ja të tregojë rezultate tani. Dhe ASK-ja ka njohuritë e nevojshme për ta bërë këtë.

ASK-ja duhet të bëjë një plan për zhvillimin e Databazës, që do të paraqesë se si do të plotësohet gradualisht përmbajtja e databazës në të ardhmen. Të gjitha statistikat duhet të përfshihen në databazës gjatë 1-2 viteve të ardhshme, duke e bërë atë një vend për të gjitha statistikat. Databazat ekzistuese, që përmbajnë pjesë të ndryshme të statistikore, mund të mbyllen pasi të jenë transferuar përmbajtjet e tyre në databazën e vetme (databankën).

AS-ja duhet ta lajmërojë këtë ngjarje në të ardhmen e afërt, sidomos tek përdoruesit, që morën pjesë në takim. Në të njëjtën kohë, ASK-ja do të duhej të organizonte një hapje të databanks, kah mesi i Janarit 2015, ku do të mund të ftoheshin edhe mediat, për ta bërë ngjarjen sa më publike që është e mundur. Kjo mund të ketë ndikim në profiling e ASK-së në shoqëri.

Para hapjes së databakës, do të mund të lëshohej një beta version për të testuar performanën e tij me përdoruesit, si një link vetëm me përdoruesit pjesëmarrës në takim.

3.2 Komunikimi me qeverinë dhe përdoruesit kryesorë

Pas hapjes së databankës, duhet të bëhet përpjekje të organizohet një takim i nivelit të lartë, nivel ministrior ose ngjashëm: qëllimi është të ndikohet në resurset e ASK-së. Espertët e vendeve anëtare mund të kontribuojnë në këtë lloj takimi.

Dë të ishte mirë që para fundit të vitit, ASK-ja të organizojë një takim koordinimi me Ministrinë e Financave dhe Bankën Qendrore, pasi një gjë e tillë u propozua nga ta. Ky takim duhet të jetë i nivelit të lartë dhe të rrisë komunikimin dhe koordinimin në të ardhmen.

3.3 Rekomandimet për punën e Grupit për Cilësi

Duhet të analizohen rezultatet nga anketa mbi kënaqshmërinë e përdoruesve, që u plotësua nga përdorues shumë të rëndësishëm. ASK-ja duhet të vendosë se si do të inkorporojë kërkesat e tyre në punën e vet në të ardhmen. Një anketë mbi kënaqshmërinë, duke mbulura përdorues të tjerë të rëndësishëm, si media, bizneset, studentët dhe publikun e gjerë, duhet gjithashtu të planifikohet për vitin 2015.

Analiza e mangësive tek stafi konsiderohet si një pike fillimi shumë e mire. Megjithatë, përshkrimet e disa kompetencave duhet të jenë më specifike dhe shpjegimet më të qarta nëse duhet të ndërmerren veprime dhe të zhvillohen këto kompetenca. Kur bëhet fjalë për fushat dhe kompetencat e stafit, është gjithashtu e rëndësishme të kihet parasysh jo vetëm detyrat që realizohen aktualisht por edhe ato të kërkuara në të ardhmen. Prandaj, do të duhej të bëhej një plan trajnimi sa më shpejt që është e mundur.

Në mënyrë që të përmirësohen procedurat e prodhimit të statistikave, nga grumbullimi i të dhënave deri te diseminimi, të gjitha këto procedura janë përfshirë në një listë kontrolluese. Kjo listë mund të zhvillohet më tej duke shtuar procedura specifike. Lista e plotësuar duhet të ruhet për dokumentimin e kontrollit të cilësisë së anketave. Duhet të bëhen të qarta dhe të dakordohen rekomandimet për punën e Grupit për Cilësi.

Një nga detyrat e Grupit për Cilësi do të ishte plotësimi të vetëvlerësimit i BE për parimin 4 të Kodit të Praktikës mbi cilësinë. Kjo do të duhej të bëhej para fundit të vitit 2014.

Një detyrë tjetër e Grupit për Cilësi do të jetë përcjellja për së afërmi e punës rreth metadatave për të siguruar progresin dhe rezultate konkrete në këtë drejtim.

Me një fjalë: fuqizimi i punës së Grupit për Cilësi (planifikoni-implementoni-monitoroni-vlerësoni).

3.4 Misioni i ardhshëm

Bazuar në diskutimet me Grupin për Cilësi, ekspertët kanë propozuar të ketë një mision mbi rishikimin e Ligjit mbi Statistikat dhe implementimin dhe koordinimin e sistemit statistikor kombëtar në Janar të vitit 2015. Megjithatë, Kryeshefi Ekzekutiv na ka informuar që projekti i SCB/Sida do të ndihmojë në rishikimin e ligjit, prandaj ky mision nuk do të jetë i nevojshëm. Si rrjedhojë, nuk ka ndonjë mision të paraparë në këtë komponent të projektit.

Një aktivitet i ri do të ishte lidhur me Politikën e Diseminimit, ndoshta në Janar 2015.

Aneksi 1. Termat e Referencës

**Projekti i Binjakëzimit i BE-se
KS12 IB ST 01
Përkrahje për Statistikat**

Komponenti 1: Një Sistem Cilësie për Statistikat
Aktiviteti 1.2.1.1: Organizimi i punës rreth cilësisë në Statistika- takimi me përdoruesit

Afatet kohore:

TeR –të gatshëm: 7 Tetor 2014

Fillimi /përfundimi i aktivitetit: 21-24 Tetor 2014

Raportimi: 31 Tetor 2014

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultati obligativ 1.2.1.1	Organizimi i punës rreth cilësisë në statistika	Raportet mbi misionet, që ofrojnë këshilla operationale për sigurimin e cilësisë në fushën prodhimit statistikor, të publikuara në faqen e projektit	- Raportet tremujore të projektit të binjakëzimit - Raportet mbi misionet - Udhëzuesit	- Përkushtimi dhe disponeshmeri a në të gjitha nivelet e stafit të ASK-së dhe menaxhmentit - Komunikimi dhe pjesëmarrja efektive e të gjitha subjekteve relevante - Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes misionëve - Resurse të mjaftueshme (njerëzore dhe materiale)
------------------------------------	---	--	--	--

Tema / qëllimi i aktivitetit: 1.2.1.1

Të ndihmohet rreth realizimit të një takimi me përdoruesit e statistikave zyrtare, në ASK.

Gjatë këtij aktiviteti gjithashtu do të vazhdojnë diskutimet dhe rekomandimet lidhur me organizimin e punës rreth cilësisë, duke përfshirë edhe arritjet që nga misioni i kaluar.

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 1.2.1.1:

Mbajtja e takimit me përdoruesit.

Raporti mbi misionin, që përshkruan gjendjen aktuale të punës rreth cilësisë në ASK.

Sugjerimet për aktivitetet e ardhshme në komponentin 1.

Ekipi në ASK:

1. Ramiz Ulaj, Drejtor i Departamentit, (Udhëheqës i komponentit, Kryesues i Grupit për Cilësi)
2. Ibrahim Rustemi, Drejtor i Departamentit të Administratës; (anëtar i Grupit për Cilësi)
3. Servete Muriqi, Zyrtare e Lartë në Metodologji
4. Bekim Canolli, Shef i Metodologjisë dhe Menaxher i Cilësisë; bekim.canolli@rks-gov.net
5. Bashkim Bellaqa, Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale, Bashkim.Bellaqa@rks-gov.net
6. Bajrush Qevani, Drejtor i Departamentit të Bujqësisë, Bajrush.Qevani@rks-gov.net
7. Xhevdie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare (anëtarë e Grupit për Cilësi)
8. Avni Kastrati, Shef i Divizionit të Popullsisë, avnikastrati@gmail.com
9. Ismail Sahiti, Shef i Divizionit të Statistikave Ekonomike (anëtar i Grupit për Cilësi)
10. Avni Zejnullahu, Divizioni i Anketave (anëtar i Grupit për Cilësi)

Ekspertët e vendëve anëtare:

Z. Lars Thygesen, Drejtor, Shitje dhe Marketing, Statistikat e Danimarkës, lth@dst.dk

Znj. Hilka Vihavainen, ish Drejtoreshe e Përgjithshme, Statistikat e Finlandës, hilka.vihavainen@gmail.com

Znj. Annegrete Wulff, Shefe e Divizionit, Statistikat e Danimarkës, awu@dst.dk

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit:

Z Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj Nora Zogaj, asistente e RTA, nzogaj@yahoo.com

Informacione shtesë

Gjatë 5 misionëve në projektin e binjakëzimit tashmë është shënuar progres në fushën e cilësisë. Është formuar grupi për cilësi dhe është emëruar menaxheri i cilësisë. Në qershor, ekspertët nga ASK-ja morën pjesë në Konferencën Evropiane mbi cilësinë në statistikat zyrtare, që u mbajt në Vjenë.

Në gusht të vitit 2014, Z. Lars Thygesen pati një mision në lidhje me çështjet e mëposhtme:

1. Organizimi i punës së cilësisë. Grupi për cilësi tashmë është formuar dhe funksionon
2. Diskutimi dhe finalizimi i drafteve për mandatin e grupit për cilësi
3. Diskutimi dhe finalizimi i draftit të deklaratës së cilësisë
4. Diskutimi i anketës lidhur me nevojat për trajnime
5. Diskutimi i anketës mbi kënaqshmërinë e përdoruesve
6. Organizimi i takimit me përdoruesit. Kush për çfarë do të jetë përgjegjës dhe afatet kohore përkatëse
7. Diskutim: Menaxhimi i qasjes tek të dhënat mikro

U planifikua që misioni tjetër të mbahej në tetor 2014 me qëllimin që të organizohet një takim me përdoruesit. ASK (Ramiz Ulaj), në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e projektit, do të organizojë dhe ftojë përdoruesit.

Aktivitetet, që duhet të ndëmirren si parapërgatitje për misionin:

- Raporti i misionit 1.0.1: Faza I: Zhvillimi i hartës rrugore për implementimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë (Vihavainen & Thygesen)
- Raporti i misionit 1.2.1: Një sistem cilësie për statistikën. Organizimi i punës rreth cilësisë (Thygesen)

Aktivitetet e pritura janë:

- Mbajtja e takimit me përdoruesit
- Rishikimi i aktiviteteve që nga misioni i kaluar
- Rishikimi gjendjes aktuale në lidhje me cilësinë

Do të përgatiten:

- Raporti mbi misionin – sipas modelit
- Një plan i detajuar për aktivitetet e ardhshme në lidhje me cilësinë në ASK

Programi - Tetor 2014

Dita	Vendi	Koha	Aktiviteti
1	ASK	10:00-16:00	Planifikimi i 4 ditëve Përgatitja e takimit me përdoruesit
2	ASK	09:00-15:30	Takimi me përdoruesit
3	ASK	09:00-16:00	Takimi me Grupin për Cilësi: Vlerësimi i takimit me përdoruesit Rishikimi i gjendjes aktuale i punës rreth cilësisë
4	ASK	09:00-15:00	Marrëveshja rreth rekomandimeve Takimi me udhëheqësin e projektit në ASK: Rekomandimet, plani kohor dhe aktivitetet për ASK-në Raportimi

Personat e takuar

ASK:

1. Ramiz Ulaj, Drejtor i Departamentit, (Udhëheqës i komponentit, Kryesues i Grupit për Cilesi)
2. Ibrahim Rustemi, Drejtor i Departamentit të Administratës; (anëtar i Grupit për Cilesi)
3. Servete Muriqi, Zyrtare e Lartë në Metodologji
4. Bekim Canolli, Shef i Metodologjisë dhe Menaxher i Cilësisë; bekim.canolli@rks-gov.net
5. Xhevrie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare (anëtare e Grupit për Cilësi)
6. Avni Kastrati, Shef i Divizionit të Popullsisë, avnikastrati@gmail.com
7. Ismail Sahiti, Shef i Divizionit të Statistikave Ekonomike (anëtar i Grupit për Cilësi)


Ekipi i Projektit të Binjakëzimit:

Z Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk


Znj Nora Zogaj, asistente e RTA, nzogaj@yahoo.com

Aneksi 2. Anketa mbi kënaqshmërinë e përdoruesve


1. Sa shpesh i keni përdorur të dhënat statistikore dhe informatat e publikuara nga ASK-ja?




2. Sa kohë ka që përdorni të dhënat statistikore të ASK-së?




3. Për çfarë qëllimesh i përdorni të dhënat statistikore të ASK-së?




4. Cilat nga fushat e mëposhtme i përdorni më së shumti?



5. Nga i merrni informatat rreth të dhënave statistikore të ASK-së?




6. Sa shpesh e vizitoni faqen e internetit të ASK-së?



7. A i gjeni zakonisht informatat që I kërkonit në faqen e internetit të ASK-së?
Të intervistuarit zakonisht gjejnë informatat në faqen e ASK-së.

8. Një vlerësim në përgjithësi për statistikat.



	Don't know	Strongly disagree	Disagree	Partially agree	Agree	Strongly agree
General satisfied	0	9.1	9.1	36.4	27.3	18.2
Meet your needs	0	0.0	18.2	27.3	45.5	9.1
Hight quality	0	0.0	18.2	54.5	27.3	0.0
Comparable	0	0.0	27.3	36.4	27.3	9.1
Published in time	0	0.0	9.1	45.5	45.5	0.0
Trustworthy	0	9.1	9.1	36.4	27.3	18.2
Fully protected	18.18	0.0	18.2	0.0	45.5	9.1

